

Konfliktet

Në rastet e konflikteve mes partnerëve apo në familje, ndihmojnë qendra të ndryshme këshilluese. Dhuna në familje ose mes bashkëshortëve është e ndaluar.

Konfliktet në marrdhëniet e partnerëve

Nëse në marrdhëniet e partnerëve lindin konflikte, partnerët mund të kërkojnë ndihmë profesionale (këshilla për çiftet, Eheberatung). Qendra të specializuara për këshilla i ndihmojnë ata të gjejnë zgjidhje. Bisedat e para zakonisht janë falas ose me çmime të ulëta. Në çdo rajon ka një qendër këshilluese e cila është përgjegjëse për këtë.

Konfliktet në familje

Në familjet me fëmijë, mund të ndodhin situata të vështira që mund të jenë të ngarkueshme për prindërit dhe fëmijët. Në çdo rast, është e rekomandueshme që prindërit të kërkojnë ndihmë nëse nuk dinë çfarë të bëjnë më tutje. Në qendrat e këshillimit për familjet (Familienberatungsstelle), mund të kërkohen këshilla personale. Në "Elternnotruf" ekspertët i këshillojnë prindërit përmes telefonit ose postës elektronike rreth edukimit dhe shqetësimeve për fëmijët e tyre (Telefoni 0848 35 45 55 (falas, www.elternnotruf.ch)). Fëmijët dhe të rinjtë mund të kërkojnë ndihmë në "Kindernotruf" përmes telefonit, postës elektronike, SMS ose bisedës (Telefoni 147 (falas), www.147.ch).

Dhuna në shtëpi

Dhuna në familje është vepër penale. Kushdo që përdor dhunë bënë vepër penale - pavarësisht nga pesha e dhunës. Nuk ka rëndësi nëse dhuna drejtohet ndaj bashkëshortit apo ndaj fëmijëve. Autoritetet duhet të ndërmarrin veprime me iniciativën e tyre kur mësojnë për dhunën në familje. Për viktimat e dhunës ka shërbime mbështetëse falas dhe të besueshme. Gratë ose burrat mund të kërkojnë mbrojtje të përkohshme bashkë me fëmijët e tyre në ambiente të posaçme për strehim (Frauenhaus / Väterhaus). Gratë e prekura nga dhuna mund të telefonojnë në Shtëpinë e Grave gjatë gjithë kohës (telefon 062 823 86 00). Fëmijët dhe të rinjtë mund të kontaktojnë përmes linjës telefonike të urgjencës për fëmijë (telefon 147 (falas), www.147.ch). Kushdo që ndihet i kërcënuar nga një pjesëtar i familjes duhet të telefonojë në polici (telefon 117). Kjo mund të çojë në largimin e personit që përdor dhunë ose kërcënon nga banesa ose shtëpia për një periudhë më të gjatë kohore.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.ciao-aargau.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/konfliktet